



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES SARANDE

Nr. 195 Prot.

SARANDE, më 28/04/2020

403
30/04/20

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimit të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganore)

Drejtuar : PREFEKTURES FIER

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 48/4 i Tij "Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve" - "Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre", në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile", neni 131 i Tij "Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale...", nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" - "Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet", si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 4, datë 07/04/2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave - "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", pika VI.6 e Tij, "Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Komunë, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe

me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”.

Për sa më lart, kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 10 (Dhjetë) ditë të akteve administrative, vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore (Nr.4, me nr.159 Prot., datë 25/03/2020; të materializuar nga ana jonë për subjektin “FIN PEK PETROLIUM” sh.a, me NIPT L01410008B, me seli ne Fier (Patos, lagjia Griz, rruga nacionale Fier-Patos ,Km 7,zona kadastrale me nr 2890,nr Pasurie 66/24+1+I me administrator z.Hamza Muho.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të vendimit të lartpërmendur.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes të ketyre vendimeve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Raimonda GJONI

